



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Drejtoria e Arsimit

Nr. 04/463

Më: 25.09.2025

Duke u bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr. 04/L-032 të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Neni 127, paragrafi 1, neni 130, paragrafi 3 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative dhe neni 11,12,13 dhe 14 me nr.02/2016 i UA –MASHTI për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, Procesverbalin e mbledhjes nga KDSH të shkollës nr.prot.1740 dt.12.09.2024, Kërkesën nr.1741 dt.13.09.2024 për lejimin e ekskursionit dhe Ofertën me nr prot.1742 i dt.13.09.2024 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Berati, Kruja dhe qyteti i Durrësit. Ekskursioni zgjatë 4 bujtje (pansion i plotë) prej datës 30/09/2024 deri më 04/10/2024.

Lista e konkurentëve për të fituar Ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjimnazit ”Hajdar Dushi” në Gjakovë, janë :

1. SH.P.K. ”Meti Commerc” me çmim 136 €;
2. SH.P.K. “Kushtrimi NMI” me çmim 130 €;
3. SH.P.K. “Armendi -Tours ”me çmim 120 €;
4. SH.P.K. ”Meti –Tours” me çmim 130 €;
5. SH.P.K. “Bledi Tours” (i mungoi oferta);

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.19/09/2024 në ora 14:00 sipas ofertës nr. 1742 i dt.13.09.2024 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe Gjimnazit ”Hajdar Dushi” Gjakovë :

- 1.Yllka Juniku Shehu – Drejtor i shkollës - Kryesues
- 2.Rifat Haxhija - Kryetar i Këshillit Drejtues të shkollës - Anëtarë
- 3.Flutur Këpuska – zyrtare e DKA - Anëtare

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese SH.P.K. “METI COMERC ” ka konkuruar me çmim prej 136 € për nxënës. Oferta bazohet në 4 (katër) fjetje me pasion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “Bonita” Golem -Tiranë ndërsa vizita qyteteve të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese. Janë të përfshirë 6 autobus dhe një minibus gjithashtu janë prezentuar gjashtë (6) shoferë të pajisur me çertifikatë mjekësore dhe një shoferë rezervë të cilit i mungon dokumentacioni - çertifikata mjekësore. Firma prej të gjithë autobusëve ka prezentuar gjithësejt 361 ulëse të cilat nuk janë të mjaftueshme për numrin e nxënësve maturant dhe stafit përcjellës.Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve

me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.08/03/2021 gjerë më dt.07/03/2026, gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit ARBK, Çertifikatën mjekësore, Vërtetimin Tatimor, Referencat për imazhin e kompanisë sipas kriterëve të Ofertës së shkollës. SH.P.K.”Meti Comerc” ka prezentuar Konfirmim Rezervimi së bashku me Licencë/Lejen e ushqimit nga Hotel “Bonita” dhe Ofertën së bashku me Menun e ushqimit për nxënësit.

Firma transportuese N.P.T. ”Kushtrimi NMI” ka konkuruar me çmim prej 130.00€, për nxënës gjithashtu ka ofruar 2 nxënës pa pagesë dhe kujdestarët e klasës. Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Sipas ofertës së prezantuar iu është ofruar qëndrimi në Hotel “Bonita “ Golem në Durrës, ku edhe ka prezantuar në Konfirmim Rezervimi e hotelit nga administratori Astrit Ismaili së bashku me Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve - Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)- Republika e Shqipërisë dhe Menuja me detajet e ushqimit të nxënësve sipas ofertës me nr.prot.1742 dt.13.09.2024 pika (i, m) të Gjimnazit “ Hajdar Dushi” në Gjakovë.

Në ofertë përfshihen katër (4) fjetje me pansion të plotë që nga dt.30/09/2024 gjer më dt.04/10/2024. N.P.T. ”Kushtrimi NMI” posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjerë më dt.14/04/2026, Çertifikatën e regjistrimit ARBK, 2 Referencat për imazhin e firmës. Gjithashtu firma “Kushtrimi NMI” ka marrëveshje – nën kontraktim me firmën SH.P.K.“Miroci Reisen” nga Juniku e cila ofron 3 autobus, të cilën e përfaqëson z. Ilker Miroci.

Firma “Kushtrimi NMI” posedon Çertifikatën e Mjekut të dr. Baton H. Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese “Kushtrimi NMI” për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Firma ka ofruar 6 shoferë të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 6 autobusë - 3 të firmës “Kushtrimi NMI” dhe 3 autobus të firmës “Miroci Reisen” të cilëve dy shoferave ju mungon patent shoferi .

Firma ka ofruar Vërtetimin tatimor mirëpo Vërtetimin e taksës në firmë e ka dorëzuar të pa vulosur nga zyra e taksës në firmë me të cilin vërtetojmë se dokumenti nuk është valid.

Firma transportuese SHPK “Armendi -Tours”-Gjakovë ka konkuruar me çmim 120,00 € për Hotelin “Bonita “ Golem në Durrës me Konfirmim Rezervimi së bashku me Parakontratën e kërkuar nga Oferta e shkollës nga hoteli në fjalë ku është e përfshirë edhe Menuja në detaje së bashku me Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve -Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)- Republika e Shqipërisë sipas ofertës me nr. prot. 1742 dt.13.09.2024 pika (i) për akomodimin e nxënësve të shkollës Gjimnazi ”Hajdar Dushi” Gjakovë. Në ofertë përfshihen katër (4) fjetje me pansion të plotë që nga 30/09/2024 deri më 04/10/2024 dhe vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë në Berat, Durrës dhe Krujë.

Firma posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.28/02/2022 gjer me dt.27/02/2027. Posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Baton Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe firmës transportuese SH.P.K. “Armendi -Tours” për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Janë ofruar 8 autobus dhe të përfshirë 8 shoferë të cilët janë të pajisur me çertifikata mjekësore dhe kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore. Gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit (ARBK) të firmës dy Referenca me imazh pozitiv dhe Vërtetimin Tatimor dhe Komunal i cili është prezentuar pjesërishtë i paguar dhe i pavulosur që është jo valid si dokument. Oferta e prezentuar nga shkolla i’u është drejtuar bizneseve

ose kompanive ku ata marrin pjesë si persona juridik jo fizik, ku duhet të prezentojnë tatimin- taksën në firmë jo në pronë.

Firma transportuese SH.P.K. "METI TOURS" ka konkuruar me çmim prej 130.00€, për nxënës ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës , të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e plazhit dhe shfrytëzimin e pishinës brenda hotelit. Oferta bazohet në 4 (katër) fjetje me pansion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel "Bonita" Shpk Golem-Durrës prej dt.30/09/2024 deri më 04/10/2024 dhe vizitat në qytetet Vlorë, Krujë , Tiranë dhe qyteti i Durrësit gjithashtu ka prezentuar edhe Menun për këto 4 ditët e qëndrimit të nxënësve. Kompania SHPK "Meti Tours" posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2024 gjer me dt.06/06/2029, Çertifikatën e Regjistrimit (ARBK) të SH.P.K "Meti Tours", Vërtetimin Tatimor (ATK) dhe Tatimin Komunal - (Taksën në firmë të nënshkruar dhe vulosur nga organi kompetent), gjithashtu firma ka ofruar 3 referenca me imazh pozitiv, posedon Çertifikatën e Mjekut dr.Baton Lleshi ku është lidhur marrëveshja mes tij dhe drejtorit Hysen Musa që përfaqëson firmën transportuese "Meti – Tours" për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës "Hajdar Dushi" në Gjakovë. Janë të përfshirë 7 shoferë të pajisur me Çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 7 autobusë të cilëve 2 autobusave ju mungon kontrolli teknik 6 mujor mirëpo të njëjtit autobus kanë afatin e regjistrimit deri më 2025 me të cilin kjo dëshmon se ka validitet. Firma ka ofruar Konfirmim Rezervimi nga Kompleksi "Bonita" të vërtetuar nga pronari Astrit Ismaili së bashku me Licencën e Agjensionit të Akreditimeve të Ushqimeve - Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)-Republika e Shqipërisë sipas ofertës me nr. prot. 1742 dt.13.09.2024 pika (i) në Gjakovë për akomodimin e nxënësve të Gjimnazit "Hajdar Dushi" e cila përkon me Parakontratën e kërkuar sipas ofertës së shkollës.

Firma transportuese SH.P.K. "Bledi bus"-Gjakovë -gjatë hapjes së ofertës pronari i firmës nuk ishte prezent dhe kishte mungesë të dokumentacionit.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, qëllimin e ekskursionit , lartësin e pagesës etj. ku me ç'rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç ku nga shkolla janë prezantuar Deklaratat e Prindërve të Nxënësve të Klasave të 12-ta si dhe Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimtarëve të Klasave të 12-ta (14 mësimdhënës kujdestarë).

Sipas procesverbalit të KD të shkollës dt.23.09.2024 nr.prt.1760 dhe procesverbalit të Këshillit të Prindërve dt.23.09.2024 dhe nr.prot.1761 është marr Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për shkollën Gjimnazi "Hajdar Dushi" Gjakovë të përzgjidhet firma SHPK "Meti Tours" me çmim prej 130 €.

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike SHPK "Meti Tours" me pronar Melazim Musa nga Gjakova .



Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurruese, Pëlqimit nga ana e Këshillit të Arsimitarëve të Klasave të 12-ta (14 arsimtarë kujdestarë), Deklaratat e Prindërve lidhur me organizimin e ekskursionit të nënshkruara nga prindërit e nxënësve pjesëmarrës në ekskursion, Procesverbalit të mbledhjes me përfaqësues të Prindërve të kl.12-ta dhe Kujdestarë të klasëve të 12-ta, Procesverbalit të KDSH dhe Procesverbalit të Këshillit të Prindërve përfaqësuesit e prindërve jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) vendos të përzgjedh për Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë firmën SH.P.K. "Meti -Tours" me çmim prej 130 € .

Kjo firmë është përzgjedhur nga përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve , në mënyrë unanime për shkak se kërkesa e tyre ishte siguria e nxënësve dhe firma në fjalë i plotëson dokumentet ligjore, duke potencuar që çmimi nuk është i rëndësishëm siq parashihet edhe në ofertën e shkollës sipas pikës (k).

Kompania e përzgjedhur në fjalë është e obliguar që nxënësit e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë që t'i respekton të gjitha zotimet në ofertë.

Komisioni selektues:

1. Yllka Juniku Shehu
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit dt.25/09/2024
(pozita)

2. Rifat Haxhija
(emri dhe mbiemri)

Anëtar dt.25/09/2024
(pozita)

3. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)

Anëtare dt.25/09/2024
(pozita)



[Handwritten signatures in blue ink]

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në Komisionin e Ankesave në Komunën e Gjakovës. Ankesa nuk ka efekt pezullues.

Procesverbali iu dërgohet:

- Shkolla "Hajdar Dushi" në Gjakovë
- Agjencive turistike
- Komisionit të Ankesave
- Arkivit